



## Shqipja standarde dhe përdoruesit

Dr. Përparim Fakaj, Msc. Suela Fakaj,  
Msc. Lorela Fakaj, Msc. Julian Fakaj

### Abstract

Language is a specific feature of human being and the most important code of communication in society. Since antiquity, the same language was what that made people to share a common territory, to feel members of the same ethnic group. Standard language is the variety of the national language of a linguistic community, that rises above other varieties and takes nationwide character. Standard of use is formalized in the Congress of the Albanian language spelling in 1972, they were placed norms in all subsystems of language. After the crystallization of norms, starting stages of their use, which is considered as the most important stage and more difficult, because it has to do with instilling these norms in consciousness of users. Albanian language over the years has recognized achievements in raising awareness of users to implement standard norms. While in the transition years was overshadowed care to preserve the purity of his and to protect the Albanian word, paving the way for the entry of more foreign words, probably some of them were legitimate by the phenomena and new concepts, while others unnecessarily due to a "snobbery" language. Similarly even in grammatical rate, which is facing with a strong pressure from foreign languages, where have entered syntactic constructions unacceptable for Albanian language. It is this situation which the Albanian language is falling alarming sirens of threat. The degree of success in acquiring the rates of standard Albanian not only depends on the codification of these norms, but also on the acceptance and implementation of the speakers. It is our duty and of the whole society to create a united front for the acquisition and the fair use of standard Albanian, where in the face of this front should remain schools, electronic media and all the institutions of state.

Keywords: rate, variety, purity, codification, pressure, construction etc.

### Abstrakt

Gjuha përbën një veçori specifike të qenies njerëzore dhe kodin më të rëndësishëm të komunikimit në shoqëri. Qysh në lashtësi, gjuha e njëjtë ishte ajo që i bënte njerëzit që ndanin një territor të përbashkët, të ndiheshin anëtarë të së njëjtës etni. Gjuha standarde është

varianti i gjuhës kombëtare të një bashkësie gjuhësore, që ngrihet mbi variantet e tjera dhe merr karakter mbarëkombëtar. Standardi të ne është zyrtarizuar në Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe në vitin 1972, ku u vendosën normat në të gjitha nënsistemet e gjuhës. Pas kristalizimit të normave, fillon etapa e përdorimit të tyre, e cila konsiderohet si faza më e rëndësishme dhe më e vështirë, sepse ka të bëjë me ngulitjen e këtyre normave në ndërgjegjen e përdoruesve. Shqipja në vite ka njohur arritje në ndërgjegjësimin e përdoruesve për zbatimin e normave të standardit. Ndërsa në vitet e tranzicionit u zbeh kujdesi për ruajtjen e pastërtisë së tij dhe për mbrojtjen e fjalës shqipe, duke hapur rrugë për hyrjen e shumë fjalëve të huaja, disa sigurisht të përligjura me dukuritë dhe konceptet e reja, kurse të tjerat pa nevojë, për shkak të një "snobizmi" gjuhësor. Po kështu dhe në normën gramatikore, e cila po ndeshet me trysinë e fortë gërryerëse të gjuhëve të huaja, ku kanë hyrë ndërtime sintaksore të papranueshme për shqipen. Është kjo situatë për të cilën shqipja po u bie sirenavë alarmuese të kërcënimit. Shkalla e suksesit në përvetësimin e normave të shqipes standarde nuk varet vetëm nga kodifikimi i këtyre normave, por edhe nga pranimi dhe zbatimi i tyre nga folësit. Është detyrë jona dhe e gjithë shoqërisë të krijojmë një front unik të përvetësimit dhe përdorimit të drejtë të shqipes standarde, ku në ballë të këtij fronti duhet të qëndrojnë shkolla, media elektronike dhe ajo e shkruar, gjithë institucionet e shtetit shqiptar.

Fjalët kyçe: normë, variantet, pastërti, kodifikim, trysni, ndërtim, etj.

### Hyrje

Gjuha cilësohet jo vetëm si një nga veçoritë më të rëndësishme të njeriut, por edhe si mjeti kryesor i komunikimit, pa të cilën shoqëria njerëzore nuk mund të ekzistojë, e për rrjedhojë, nuk mund të ketë as zhvillim e as organizim të saj. Atë e përkufizojmë si një sistem shenjash që mundëson komunikimin mes njerëzve dhe si prodhim shoqëror që përbën hallkën kryesore të lidhjes së individit me shoqërinë. Kjo lidhje duhet kuptuar në mënyrë të tillë që, pa komunikim me anë të gjuhës, as që mund të mendohet lindja dhe ekzistenca e shoqërisë, ashtu si nuk mund të mendohet jeta e gjuhës jashtë saj.



Si mjeti themelor i përcjelljes së përvojës njerëzore nga një brez tek tjetri dhe nga një bashkësi tek tjetra, gjuha ndikon fuqishëm në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë njerëzore. Po edhe shoqëria ndikon mbi gjuhën, duke kërkuar që kjo të ndjek hap pas hapi dhe të pasqyrojë përparimin e saj. Në këtë mënyrë gjuha ndryshon pandërprerë për t'iu përshtatur kërkesave të shoqërisë. Gjuha mbart në vetvete tipare dhe karakteristika të kombit që përfaqëson. Ajo shpreh vlerat dhe identitetin e tij.

Qysh në lashtësi, gjuha e njëjtë ishte ajo që i bënte njerëzit që ndanin një territor të përbashkët, të ndiheshin anëtarë të së njëjtës etni. Pikërisht, të dashuria për gjuhën dhe dëshira për ta pasur atë edhe në formën e shkruar, e gjejnë motivin gjithë përpjekjet e njerëzve të shquar për krijimin e alfabetëve me synimin për t'i futur popujt e vet në rrugën e qytetërimit. Nevoja e grafizimit të gjuhës lind atëherë kur një bashkësi gjuhësore arrin një shkallë të atillë njësimi sa të krijojë një bashkim shpirtëror e politikë të ngjashëm me shtetin. Fazën më të lartë të zhvillimit të saj e përbën **standardizimi**. Zgjerimi i shoqërisë bën të domosdoshme nevojën e disa normave për rregullimin e veprimtarisë së saj të gjithanshme. Një ndër këto norma është edhe ajo gjuhësore.

Njësimi gjuhësor është i rëndësishëm edhe për njësimin kombëtar e politik, për bashkimin e njerëzve rreth një ideali patriotik e politik, për institucionalizimin e shtetit në të gjitha strukturat e funksionimit të tij, etj. Gjuha jonë e lashtë dhe e patjetërsueshme, është ajo që na ka mbajtur deri më sot të njësuar e të bashkuar si popull e si komb shqiptar, na ka dalluar prej kombeve të tjera dhe na ka vlejtur si tipar i parë dhe përbashkues, ndonëse edhe të ndarë e të përhapur në disa shtete të Ballkanit e gati në mbarë Evropën si diasporë. Duke qenë se shihet si element themelor për kulturën e një kombi, ruajtja dhe pasurimi i vazhdueshëm i saj ka qenë dhe mbetet detyrë e përhershme.

Në rrjedhë të historisë, gjithë përpjekjet shekullore për të mbrojtur vetëqenien, lirinë dhe dinjitetin kombëtar kanë synuar të mbajnë gjallë dashurinë për atdheun dhe gjuhën amtare. Ideali patriotik bashkoi rilindësit në luftën dhe përpjekjet për pavarësinë kombëtare e për ruajtjen e vlerave të gjuhës sonë të bukur, sepse, - siç thotë Idriz Ajeti, - gjuha letrare s'është vetëm thesar i kulturës sonë, por edhe mjet i fortë për mbrojtjen e etnisë sonë"(1), apo siç thotë patriarku i gjuhës shqipe, prof. E. Çabej "gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar!"(2).

Gjuha e sotme letrare është rezultat i një procesi të vështirë prej më shumë se një shekull, i cili ka nisur me Rilindjen Kombëtare, kur çështja e një gjuhe të përbashkët, të njësuar e të përpunuar u shtrua si kërkesë e domosdoshme për vetë afirmimin e kombit shqiptar e për mbrojtjen e kulturës së lashtë e të pasur të tij. Punën e tyre gjigante e vazhduar shumë atdhetarë të tjerë, nga dekada në dekadë, por më intensive e sistemore ajo që pas Çlirimit të vendit.

Në këtë kumtesë kemi bërë objekt trajtimi *kristalizimin e normave të shqipes standarde dhe përdorimin e tyre gjatë nevojave komunikative*, me mëtimin e thjeshtë në dukje, por madhështor në thelbin e vet: si ta flasim bukur

shqipen, pa gabime e shtrembërime, si ta shkruajmë atë sa më thjeshtë e sa më drejt, si ta mbrojmë nga ndikimet e huaja në shkrim e shqiptim, si ta bëjmë që bukuria e të folmeve popullore dhe e dialekteve të shqipes të mos mbetet e anësuar dhe e pavlerësuar, por të vlejë si pasuruese dhe përtëritëse e shqipes së njësuar të përbashkët, si të veprojmë me rregullat e drejtshkrimit dhe gramatika e shqipes?

### Tradita shkrimore e shqipes

Dihet se qytetërimi i një populli lidhet ngushtë edhe me traditën shkrimore. Atë e kushtëzojnë shumë faktorë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë. Shqipja dhe shqiptarët janë pjesë e Gadishullit Ballkanik, e këtij gadishulli ku jetojnë popuj të ndryshëm, që janë trashgimtarë kulturash dhe gjuhësh të ndryshme jo vetëm të familjes indoevropiane, por edhe të familjeve të tjera gjuhësore. Prandaj brenda kësaj hapësire bashkëjetese e fqinjësie historike në fushën e kulturës materiale e shpirtërore ka edhe ndikime. Megjithatë, shqiptarët kanë trashëguar dhe ruajtur me kohë individualitetin e tyre kulturor dhe gjuhësor.

Pas traditës treshekullore qysh nga vepra e Buzukut, lëvrimi i shqipes mori një hov të madh gjatë shek. XIX, sidomos në gjysmën e dytë dhe në fillim të shek. XX. Lëvrimi i saj u frymëzua nga ideali patriotik dhe kushtet në të cilat ndodhej Shqipëria e kohës. Duke e konsideruar gjuhën si tipar të kombit, rilindësit ngritën lart vlerat e gjuhës sonë të bukur, të mirë, të lehtë, e të lirë, - siç thoshte Naimi ynë i madh.

Ky ideal justifikonte lëvizjen e madhe pastruese dhe pasuruese që ata ndërmoren. Prof. Shaban Demiraj e vlerëson punën e rilindësve për një alfabet të përbashkët si detyrën më të ngutshme të kohës, sepse në asnjë nga alfabetet e gjuhëve të Gadishullit Ballkanik nuk u hartuan aq alfabete sa në shqipe, duke u përpiluar mbi 150 variante e nënvariante. Ky mozaik variantesh nuk pasqyronte strukturën fonetike të shqipes. Përdorimi i shumë varianteve nuk ishte diçka e favorshme për kulturën tonë, mbasi u bë pengesë për një zhvillim të shpejtë të gjuhës dhe të shkrimit shqip. Vendimi i atdhetarëve shqiptarë për të krijuar një alfabet të përbashkët, që njihet me emrin "alfabeti i Stambollit" (1879), buronte nga nevoja për unifikimin e alfabetit. Megjithëse nuk mundi të përhapej gjithandej e të bëhej alfabeti i vetëm për shkrimin e gjuhës shqipe, pasi në Shqipërinë e Veriut përdroreshin alfabete të tjerë, si ai i shoqërisë "Bashkimi" dhe i shoqërisë "Agimi" më 1901, hartimi i alfabetit të Stambollit zgjidhi përfundimisht raportin tingull - shkronjë, duke i dhënë fund atij përshtjellimi që ekzistonte deri në atë kohë, kur numri i shkronjave për shqipen shpesh i kalonte caqet e tinguj-fonemave të gjuhës sonë, rrjedhojë e mosnjohjes sa duhet të strukture fonetike të shqipes.

Përpjekjet për hartimin e një alfabeti të përbashkët u kurorëzuan me Kongresin e Manastirit në vitin 1908, i cili ligjëroi alfabetin që kemi sot, mbështetur në atë latin. Dhe kështu kultura shqiptare sanksionoi përfundimisht emancipimin kulturor drejt Evropës së qytetëruar, u bë faktor i rëndësishëm i individualiteti kulturor. Shpallja



e pavarësisë do të shënonte fillimin e një etape të re në lëvizimin dhe përpunimin e shqipes, e cila u bë gjuha zyrtare e shtetit të ri shqiptar e do të mësohej lirisht nëpër shkolla. Edhe në këtë periudhë vazhduan përpjekjet e mëtejshme për pasurimin dhe përpunimin e shqipes. Deri në këtë kohë nuk kishim një gjuhë letrare të njësuar me gjithë përpjekjet e bëra për njësimin e saj e afrimin e dialekteve, ku ky problem u shtrua me forcë pas Çlirimit të vendit, që gjeti zgjidhje përfundimtare me Kongresin e Drejtshkrimit në vitin 1972, ku u pranua një shqipe e vetme letrare me norma të njësuara jo vetëm në drejtshkrim, por dhe në gramatikë, fonetikë, e leksik .

### **Ç'kuptojmë me gjuhë standarde dhe cilët janë rrugët e formimit të tyre?**

Gjuhët standarde lindin në etapa historike, kur formohen a forcohen bashkësi të mëdha shoqërore dhe kur shoqëria ndien nevojën e një komunikimi sa më të gjerë, të cilin nuk arrijnë ta përmbushin varietetet dialektore. (3). Pra, normësimi bëhet në radhë të parë për nevoja komunikimi. Nganjëherë ai bëhet edhe për nevoja të tjera, si për shembull për të siguruar mbizotërimin e një grupi ndaj një tjetri. *Gjuha standarde ose siç quhet ndryshe, standardi, është varieteti i gjuhës në të cilin pjesëtarët e kësaj bashkësie pranojnë të komunikojnë.* (4).

Në krijimin e gjuhëve standarde ndikojnë faktorë të brendshëm gjuhësorë (përsosja strukturore e funksionale e gjuhës, konvergimi ose afrimi i dialekteve) dhe faktorë të jashtëm shoqërorë (objektivë dhe subjektivë). Formimi i tyre bëhet kryesisht për arsye jashtëgjuhësore. Këto arsye janë: politike, fetare, ekonomike, dhe më rrallë, edhe kulturore. Por, gjuhët standarde mund të lindin në hapësira gjeografike ku bashkimi politik është i mëvonshëm, p. sh. italishtja, gjermanishtja, etj. Në këto raste standardi nuk është krijuar për arsye politike. Për shembull, standardizimi i gjermanishtes mori si pikënisje përkthimin e Biblës nga Martin Luteri.

Në përgjithësi, procesi i standardizimit njihet këto drejtime:

- a. Zgjedhja e një varieteti për model;
- b. Ngulitja e një norme të shkruar;
- c. Institucionalizimi nëpërmjet mësimdhënies, traktateve normative, instituteve e akademive, organizmave shtetërorë, letërsisë e medias.

Deri në ditët e sotme njihen disa mënyra formimi të gjuhëve standarde:

- a. Njeri dialekt jep varietetin e standardit, duke imponuar normën e tij të tjerëve, p. sh. hindi në Indi, koineja atike për greqishten antike, kastiliani në Spanjë, etj.
- b. Secili nga dialektet jep pjesën e vet, pa imponuar normën e tij. P. sh. mandarini (guanhua) dhe pasardhësja e tij e sotme "gjuha e përbashkët" (putonghua) për kinezishten, gjermanishtja e epërme për vendet gjermanofone, etj.
- c. Një dialekt jo drejtpërdrejt i afërm me ta, u imponon normën e vet dialekteve të tjera, p. sh. imponimi i danishtes nga shekulli i 16-të deri në fillim të shekullit të 19-të në Norvegji.

Sipas kësaj skeme shqipja del të jetë formuar sipas modelit të parë dhe të dytë. Arsyet pse një bashkësi

përzgjedh njërën prej modeleve të standardizimit janë të ndryshme. Në kësi rastesh veprojnë shumë faktorë, si: gjeografikë: pozicioni i një varieteti është qendror për folësit që përfshihen në këtë proces; politikë dhe ekonomikë: sundimi politikë dhe ekonomik i një grupi ndaj një tjetri; gjuhësorë: një varietet ka një pozicion të ndërmjetëm midis dialekteve që përfshihen në proces.

Një përkufizim më gjithëpërfshirës për gjuhët standarde është: *"Gjuha standarde është një varietet i gjuhës kombëtare të një bashkësie gjuhësore, i cili ligjërohet e ngrihet mbi varietetet e tjera, sepse në çaste të caktuara historike gjen mbështetjen e forcave sunduese politike dhe institucionalizhet e merr vlerat e një mjeti të komunikimit ndërkrahinor, mbarëkombëtar"*(5).

### **Standardizimi i shqipes dhe kristalizimi i normave të saj.**

Gjuha shqipe, ashtu si çdo gjuhë letrare e kombeve të qytetëruar, është pasqyra më e qartë e kombit, si dhe e kulturës së tij të përbashkët. Siç thotë akademiku Rexhep Qosja *"gjuha është biografi e popujve, sepse me gjuhën, më mirë se në çdo dokument material ruhet historia e tyre intelektuale, sociale dhe morale"*(6). Në gjendjen e sotme gjuha letrare shqipe karakterizohet nga kristalizimi i normës letrare me të gjitha nënsistemet: në fonetikë, në leksik e në gramatikë e në fjalëformim, në drejtshkrim, etj. .

Standardizimi i gjuhës shqipe nuk është kryer menjëherë dhe në mënyrë mekanike. Ai ka kaluar nëpër disa etapa: që prej viteve 60 të shekullit XIX deri në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar (1912); prej 1912 e deri më 1944 dhe prej 1944 e deri në ditët tona. Këto etapa i bashkon një vijë e vetme zhvillimi, vija e konvergencës gjuhësore gjithnjë në rritje e pa kthim prapa.

Ajo, - siç shprehet prof. J. Thomai, - ka arritur në këtë shkallë nëpër një rrugë të gjatë e të vështirë, duke i bërë ballë ndikimit të huaj asimilues, duke kapërcyer ndarjen dialektore dhe duke zhvilluar trajtat e saj të përbashkëta. Fillimet e saj historike gjuha e sotme standarde shqipe i ka që në periudhën e Rilindjes kombëtare, kur lufta për kulturën dhe për gjuhën ishte e lidhur ngushtë me lëvizjen e gjerë politike, shoqërore e kulturore dhe me luftën e armatosur për pavarësi."(7).

Gjuha shqipe, siç dihet, është një gjuhë e lashtë, por e dokumentuar me shkrim vonë. Atë e gjejmë të dokumentuar në dy variante letrare kryesore, të ndërtuara mbi baza dialektore që nga "Formula e pagëzimit", "Ungjilli i Pashkëve", "Meshari", i Gjon Buzukut e nga veprat e tjera të shekujve XI-XVII. Përpjekjen e parë për njësimin (unifikimin) e shqipes së shkruar e ka bërë K. Kristoforidhi në vitet '60 të shekullit XIX, i cili shkroi në të dy variantet letrare ose dialektet kryesore që ekzistonin në atë kohë: toskërishten dhe gegërishten letrare; përpjekje që tregoi se dialektet shqipe janë shumë afër njëri-tjetrit.

Gjatë Rilindjes, mësimi dhe lëvrimi i gjuhës amtare, përpjekjet për pasurimin e saj dhe pastrimin nga fjalët e huaja dhe të panevojshme, zinin vendin qendror. Gjatë kësaj periudhe u arrit të përvijoheshin dy variante letrare të kombit shqiptar, varianti letrar *jugor* dhe varianti letrar



*verior*, si dhe të krijohej një alfabeti i vetëm, në vend të mozaikut shumë të copëzuar të shkrimeve të së kaluarës, që mbështeteshin në të folme krahinore e nëndialektore. U bënë përpjekje për afrimin e këtyre varianteve dhe për njësimin e gjuhës letrare.

Rilindësit shkruan shumë vepra, botuan dhe gramatika të shqipes, por mbetej pa bërë një nga shtyllat e gjuhës shqipe, **fjalori i saj**, i cili do të pasqyronte pasurinë leksikore e frazeologjike të kohës së tyre, punë që ata e filluan, por që mbeti në mes e nuk u botua. Puna që bëri Rilindësit për të nxjerrë në dritë dhe për të hedhur në qarkullim fjalët dialektore nëpërmjet fjalorëve të tipave të ndryshëm, ishte një komponente e fuqishme e idesë së përgjithshme të vlerësimit të çdo elementi gjuhësor shqip si pasuri e përbashkët kombëtare me synimin në të ardhmen drejt njësimin të normës letrare, me idenë madhore: **një komb një gjuhë**.

Pas shpalljes së Pavarësisë vazhduan përpjekjet e mëtejshme për pasurimin dhe përpunimin e shqipes. Një hap tjetër për njësimin e gjuhës letrare shqipe ishte veprimtaria e Komisionit Letrar të Shkodrës, në vitin 1916. Këtu, një komision gjuhëtarësh e shkrimtarësh, krijuar për të ndihmuar në formimin e një gjuhe letrare të përbashkët përmes afrimit të dy varianteve letrare në përdorim, vlerësoi variantin letrar të elbasanishtes, si një urë në mes të toskërishtes dhe gegërishtes dhe përcaktoi disa rregulla për drejtshkrimin e saj.

Vendimet e Komisionit letrar shqip për gjuhën letrare dhe për drejtshkrimin e saj, u miratuan më vonë dhe nga Kongresi Arsimor i Lushnjës (1920) dhe vijuan të zbatoheshin deri në Luftën e Dytë Botërore. Gjatë kësaj kohe shtohen botimet e gjithanshme, duke i parë në kuadrin e visareve kombëtare. Në faqet e revistave "*Shkolla kombëtare*" (1937-1939 e 1943) e "*Normalisti*" (1929-1935 e 1945), në "*Visaret e kombit*" (1941-1944) etj., vijonë fjalë e shprehje të mbledhura drejtpërdrejt në popull.

### Probleme të shqipes së sotme

Qysh në Konsultën e Prishtinës të prillit 1968, u hodh hapi i sigurtë për njësimin e normës drejtshkrimore, deviza e së cilës ishte "një komb-një gjuhë letrare, një drejtshkrim". Kjo bindje në rrethet intelektuale të kohës, sidomos në Kosovë, ishte forcuar e ngulitur nisur dhe nga synimet e Beogradit për të nxitur ndarjen gjuhësore të shqiptarëve, që do të pasohej më vonë me ndarjen kombëtare të tyre.

Në literaturën gjuhësore pranohet se drejtshkrimi zë një vend ballor ndër normat e tjera të gjuhës. Kjo shpjegohet, së pari, me rolin udhëheqës të gjuhës së shkruar në procesin e standardizimit, ndërkohë që nuk mund të thuhet e njëjta gjë për gjuhën e folur, norma ortoepike e së cilës njësohet më pas; së dyti, me vetë natyrën e kodit drejtshkrimor, rregullat e të cilit pasqyrojnë në thelb atë që është arritur në strukturën fonetike, gramatikore e leksikore të gjuhës letrare kombëtare. Pra, drejtshkrimi, nga njëra anë, pasqyron në të shkruar ç'është arritur në kodifikimin e normës në rrafshet e tjera, dhe, nga ana tjetër, i paraprin kodifikimit të normave të tjera të gjuhës, sidomos kodifikimit të normës fonetike. (8).

Tashmë ne kemi një gjuhë letrare të njësuar. Kjo u pranua që në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit në vitin 1972. Njësimi i saj është çmuar si një arritje e madhe kulturore e popullit shqiptar, prandaj pastrimi dhe pasurimi i gjuhës letrare shqipe ka qenë dhe mbetet detyrë parësore e vetëqenies kombëtare. A. Kostallari thekson se "gjuha jonë letrare e sotme u krijua si një gjuhë me të vërtetë kombëtare, mbidialektore e me vlera shoqërore të gjithanshme"(9). , prandaj çdo njësi që do të hynte në leksikon e saj i kërkohej të fitonte vlera gjithëkombëtare, mbidialektore dhe shoqërore të gjithanshme.

Siç dhe u deklarua në Kongresin e Drejtshkrimit, pas kristalizimit të normave, fillon etapa e përdorimit të tyre, e cila konsiderohet si faza më e rëndësishme dhe më e vështirë, sepse ka të bëjë me ngulitjen e normave në ndërgjegjien e përdoruesve. Për këtë e rëndësishme është të kemi një koncept të qartë për gjuhën dhe ligjërimin, si dhe raportin e ndërsjellë mes tyre. Në konceptin *gjuhë* përfshijmë gjithë mjetet tingullore të komunikimit me gojë (fonemat, morfemat, fjalët, etj.) si dhe rregullat e kombinimit të këtyre mjeteve, vështrimin në mënyrë të shkëputur nga çdo përdorim konkret i tyre. Ndërsa me konceptin *ligjërim, ose të folur*, kuptojmë procesin e komunikimit me anë të gjuhës, shfrytëzimin konkret të mjeteve gjuhësore nga individët e veçantë për të kumtuar mesazhe, d. m. th. ai përbën aktin konkret të përdorimit të gjuhës, formën në të cilën ajo përjashtësohet. Por, gjuha dhe ligjërimi lidhen ngushtë mes tyre si e përgjithshme me të veçantën. Ashtu si nuk mund të ekzistojë e veçanta pa të përgjithshmen, po ashtu nuk mund të ketë ligjërim pa gjuhë. Nga ana tjetër, edhe ligjërimi është i domosdoshëm për qenien e gjuhës, e cila mund të ekzistojë vetëm duke u përdorur, d. m. th. vetëm në të folur. **Një gjuhë që nuk flitet e ndërpret rrjedhën e saj të zhvillimit dhe vdes.** Gjuhë të tilla, si latinishtja, greqishtja e vjetër, etj., që kanë pushuar së përdoruri, quhen gjuhë të vdekura. Ligjërimi luan një rol aktiv ndaj gjuhës, pasi çdo akt i veçantë i të folurit nuk është një riprodhim i thjeshtë i mjeteve dhe i rregullave ekzistuese të gjuhës, por edhe një akt rikrijimi. Secili folës fut diçka të re qoftë në realizimin tingullor të njësive, qoftë në inventarin e njësive, qoftë në rregullat e përdorimit të tyre. Pra, gjuha zhvillohet vetëm nëpërmjet të folurit. Gjuha e sotme shqipe ka ndryshuar në krahasim me gjuhën e "Mesharit" të Buzukut. Nuk ka dyshim se zhvillimi që ka pësuar shqipja është rrjedhim i veprimtarisë ligjërimore të miliona folësve gjatë shumë brezave.

Shqipja në vite njohu arritje në ndërgjegjësimin e përdoruesve për zbatimin e normave të standardit. Ndërsa në vitet e tranzicionit si rezultat i ndryshimit të sistemit dhe të hapjes së Shqipërisë me botën, shqipja përjetoi një lëvizje të brendshme në disa shtresa të saj, u zbeh kujdesi për ruajtjen e pastërtisë së tij dhe për mbrojtjen e fjalës shqipe, duke hapur rrugë për hyrjen e shumë fjalëve të huaja, disa sigurisht të përligjura me dukuritë dhe konceptet e reja, kurse të tjerat pa nevojë, për shkak të një "snobizmi" gjuhësor. Kjo solli gjendjen e kalimit nga një vlerësim shumë i lartë për gjuhën dhe kulturën e saj në sistemin e mëparshëm, në një liri të



plotë e në një qëndrim gati të hapët të pakujdesshëm ndaj gjuhës së njësuar dhe kulturës së gjuhës në përgjithësi. Një situatë e tillë kishte si shkak kushtet e reja të krijuara nga hapja e Shqipërisë me botën dhe e vrullit për të mësuar shpejt e sa më mirë gjuhët e huaja, sidomos anglishten dhe italishten; kujdesi shumë i pakët e, ndonjëherë, edhe shpërfillje e shqipes letrare, e cila tashmë u ka rënë sirenave alarmuese të kërcënimit.

Po përmendim një fakt lidhur me vlerësimin kombëtar të bërë nga *Agjencia kombëtare e provimeve* të klasat e treta dhe të pesta, ku ka rezultuar se 24. 1 për qind e nxënësve në klasë të tretë nuk kanë shkruar asgjë, kur u është kërkuar një ese; aty thuhet se 27 për qind e nxënësve nuk dinë t'i shkruajnë **numërorët e thënë** me fjalë dhe anasjelltas. Nxënësit e klasës së pestë që nuk shkruajnë një ese janë në masën gati 34%, pra, ka një rritje të tyre. Ndërsa ata që nuk dinë të shkruajnë numërorët janë 32 %, edhe këtu me rritje. Shqetësim është jo vetëm për atë që ndodh në shkollë në punët me shkrim të nxënësve, por më tepër nga ajo që bëjmë keq ose që nuk e bëjnë ashtu si duhet strukturat drejtuese të shkollave e të institucioneve botuese. Pra, më shumë se rezultatet e nxënësve, shqetësimi lidhet me atë që është bërë këto vitet e fundit nga Ministria e Arsimit, nga Shteti dhe institucionet e varura prej tij ndaj gjuhës shqipe. Me të drejtë prof. Emil Lafe flet për "mungesën e disiplinës së shtetit".

Deformimet në mund t'i vërejmë në të gjitha nënsistemet, por në këtë kumtesë për vetë hapësirat e saj do të përvijojmë vetëm disa momente:

*Së pari*, nga deformimet më të rëndomta vihet re përdorimi pa nevojë e në disa raste edhe në mënyrë të gabuar i një numri të madh fjalësh të huaja, si: *surprizohem* ( në vend të befasohe), *impakt* ( në vend të ndikim), *impresion* ( në vend të përshtypje), *resurse* (në vend të burime), *trend* ( në vend të prirje), *bilaterale* (në vend të dypalëshe), etj.

*Së dyti*, disa fjalë të huaja që janë bërë pjesë e leksikut të gjuhës shqipe po shqiptohen gabim duke shtuar ose hequr tinguj ose duke zëvendësuar një tingull me një tjetër, si: *infakt* apo *infrakt* (në vend të infarkt), *prespektivë* (në vend të perspektivë), *adresë* (në vend të adresë), *albitër* (në vend të arbitër), etj.

*Së treti*, disa fjalë që në gjuhën burimore kanë një *c* ose *gtë* ndjekur nga një *e* ose *i*, shkruhen gabimisht me *xh* ose me *g*, në vend që të shkruhen me *c* përkatësisht me *gj*, sipas drejtshkrimit të shqipes standarde. Kështu shkruhet *çertifikatë* në vend të *certifikatë*, *defiçit* në vend të *deficit*, *proçes* në vend të *proces*, etj.

Në këtë intensitet kontaktesh me gjuhët e tjera, një vend të rëndësishëm zënë marrëdhëniet e shqipes me anglishten si gjuhë ekspansive e kohës. Përhapja e anglishtes në komunikimin e sotëm lidhet me epërsinë ekonomike të SHBA në tregun botëror. Ky faktor ka qenë i pranishëm në të gjitha kohët (të kujtojmë ekspansionin e greqishtes dhe latinishtes në të kaluarën në tërë pellgun e Mesdheut). Lidhjet ekonomike ndërkombëtare ndikojnë edhe në ekspansionin gjuhësor. Gjuha angleze po ushtron një presion të jashtëzakonshëm mbi shumë gjuhë të globit.

Çështja e huazimeve duhet vlerësuar në kontekstin e

sotëm kulturor, ku krahas rritjes së karakterit kombëtar, gjithnjë e më shumë po fiton edhe tipare e elemente ndërkombëtare. Në kushtet e sotme të qarkullimit të lirë të njerëzve është favorizuar mjaft përzierja ndërkulturore. Historikisht në të gjitha gjuhët evropiane, kanë ekzistuar e vijojnë të ekzistojnë disa sfera të leksikut të ashtuquajtura *kozmpolite*, në të cilat ka shumë *ndërkombëtarizma*. Të tilla janë fjalët që lidhen me *veshjen* dhe *modën*, me *artin*, me *shkencën* dhe *teknologjinë*, me *tregtinë*, *politikën* ndërkombëtare. Po të shohim emërtimet e dyqaneve do të shohim një mori fjalësh të huaja të përdorura si emërtime të tyre. P. sh. në çdo dyqan veshjesh po përdoret në masë fjala frënge *boutique* me kuptimin dyqan. Për mendimin tonë një emërtim i tillë po përdoret pa vend për çdo dyqan veshjesh, kur dihet që në gjuhën burimore, pra, në gjuhën frënge, përdoret me kuptimin e dyqaneve të veshjeve për *gra të stilistëve të njohur*. Prandaj, kjo fjalë duhet të vendoset në dyqanet që tregtojnë rroba të tilla dhe jo në çdo dyqan, ashtu si përdoret sot.

Sot në ligjërimin e përditshëm kanë vërshuar dhe po dëgjojmë të përdoren shumë fjalë të huaja të panevojshme, shtim i termave të huaj në vend të termave shqip që përdoren normalisht dhe nuk ka pse të mënjanohen. Kanë hyrë e nuk pushojnë së hyri edhe jo pak mënyra të thëni apo ndërtime sintaksore të papranueshme për shqipen, thjesht si ndikim nga gjuhët e huaja. Këto mënyra të thëni të huaja, jo vetëm të panevojshme, por shpesh edhe të pahijshme e të pamoralshme, siç janë, ndër të tjera, fjalët e pista në emisionet e mjaft shfaqjeve të humorit dhe në emisionet televizive, sidomos në emisionin "Zonë e lirë" të gazetarit Arjan Çani, të cilat edhe mund t'i quajmë "*pornoligjërime*".

Norma e sotme gramatikore po ndeshet me trysninë e fortë e gërryerëse të gjuhëve të huaja, sidomos të gjuhëve që dallohen shumë nga natyra eptimore e shqipes, si anglishtja, gjuhë idiomatike që nuk ka as lakim emrash, as zgjedhim foljesh, etj. Ndikimi i strukturave gramatikore, i drejtshkrimit dhe i shqiptimit të gjuhëve të huaja, pa përmendur vërshimin e fjalëve dhe termave të huazuar, po ia marrin frymën shqipes, duke dëmtuar e duke e shëmtuar sidomos etnografinë e të folurit shqip. Deri edhe pasthirrat shqipe po zëvendësohen me ato të gjuhëve të huaja, por edhe strukturat sintaksore po përzihen me ato të gjuhëve të huaja, po vihet re një epidemi gjithëprishëse për ta thënë çdo gjë mbrapsht, si: *mbrëmjen e së hënës* në vend të ndërtimit shqip *ditën e hënës në mbrëmje* ose *rrëmbeu çmimin e parë* në vend të *fitoi çmimin e parë*, etj.

Këtë situatë e vëmë re jo vetëm në gjuhë, por edhe në krejt kulturën e sotme shqiptare në tranzicion dhe që këtej lind detyrimi që të gjithë të punojmë me devotshmëri e përkushtim për ta mbrojtur gjuhën tone të bukur, sepse sa të rrojë shqipja në gojën e shqiptarëve, sa të ketë njerëz që e duan, e flasin dhe e vënë atë mbi çdo gjuhë tjetër, do të rrojë edhe shqiptaria dhe ndjenja e përkatësisë sonë kombëtare. Prandaj detyra jonë është që të mos përulemi ndaj së huajës, të mbrojmë tonën, sidomos atë pjesë që dihet se e kemi të mire e të bukur: strukturën morfologjike dhe sintaksore të shqipes.



Por, hapja e Shqipërisë me botën dhe zhvillimet globalizuese do të sjellin më tej fjalë e mënyra të thëni të huaja, të cilat duhet t'i kalojmë përherë në sitë. Dihet se asnjë gjuhë nuk mund të gjallojë e të zhvillohet krejtësisht e veçuar dhe e mbrojtur nga depërtimet e jashtme. Faktorë të ndryshëm, historikë, gjeografikë, kulturorë, veprojnë në ndërkëmbimin gjuhësor. Huazimet nga gjuhët e tjera janë një rrugë e njohur pasuruese e leksikut të çdo gjuhe. Në përgjithësi ato plotësojnë vendet e zbrazëta në gjuhën marrëse, por kur hyjnë pa nevojë ato e rëndojnë gjuhën dhe e bëjnë atë të pakuptimshme.

**Fjala e shkruar në botimet zyrtare dhe në gazeta e revista,** për njerëzit e zakonshëm merret si e mirëqenë, prandaj ato duhet të jenë pa gabime drejtshkrimore, pa fjalë të huaja të panevojshme, etj. E tillë, e kujdesur dhe pa gabime duhet të jetë edhe gjuha e gazetarisë së folur. Kur folësja është e bukur dhe flet bukur, gjuha e saj ndikon më shumë dhe duket edhe më e bukur. Por ndikimet e gjuhëve të huaja i shohim edhe në formën e shkruar duke thyer normën drejtshkrimore të shqipes. Kujtojmë ndër këto: shkrimin me shkronjë të madhe të emrave të stinëve, muajve dhe ditëve të javës, kur drejtshkrimi ynë i kërkon të shkruhen me shkronjë të vogël; shkrimin me vizë në mes (anti-stres, jo-qeveritar etj. ) ose ndarazi (jo fitimprurës, jo publik etj. ) të një vargu fjalësh me parashitesa, që shqipja i kërkon të shkruhen bashkë (antistres, joqeveritar, jofitimprurës, jopublik, etj. ); përdorimin e disa shkronjave ose togje shkronjave, që shqipja ose nuk i ka fare (shkruhet, fjala vjen, Washington) me w në vend të Uashington, staff me dy f në vend të staf) ose nuk i ka me ato vlera si anglishtja; përdorimin e trajtave angleze të disa emrave të shteteve e qyteteve në vend të trajtave shqipe të hershme e të rrënjosur tashmë (thuhet e shkruhet Florencë për Firenze, Belarus për Biellorusi, etj. ).

Gjuha që përdorin politikanët dhe personalitetet publike vazhdon të jetë gjuhë e papërkthyer, e cila po kështu ka një ndikim të madh, pasi gjen pasqyrim të përditshëm në median pamore dhe të shkruar. Nga politikanët sot dëgjon të flitet për *workshop*, *impakt financiar*, *politikë permanente dhe të përhershme*, *intrasigjencë politike*, *mazhorancë*, *observatorë ndërkombëtarë*, *lancim nismash*, *afëra*, *ndryshime të bëra viable*, *task force* etj. Është bërë normale që gazetarët, prezantuesit, politikanët dhe së fundi njerëzit e thjeshtë po përdorin fjalë të huaja në vend të fjalëve shqip. Në disa raste, disa programe nuk titullohen në shqip fare siç janë "*deja vu*" "*top story*" "*top show*" "*aldo morning show*" "*game over*", etj. I madh është edhe numri i anglicizmave që nuk u gjendet lehtë prejardhja ose numri i përkthimeve në mbështetje të anglicizmave ose gjuhëve të tjera. Si këto: *attachment*, *chat billboard*, *bluetooth*, *bookmark*, *boyband*, *site*, *browser*, *fashion*, *network*, *reality show* etj.

Sipas studiuave të kësaj fushe, fjalët e huaja nuk e rrezikojnë korpusin e gjuhës marrëse. Lënda e re gjuhësore, e huaj ose vendëse, në rast se integrohet në sistem ose pranohet si element i vlefshëm që ndihmon të kuptuarit ose komunikimin, në asnjë aspekt nuk mund të jetë i dëmshëm. Përkundrazi, në rast se ndihmon komunikimin gjuhësor dhe nuk prish veçoritë themelore

të sistemit gjuhësor, paraqet element të rëndësishëm të pasurimit të gjuhës, i shërben zhvillimit gjuhësor. Modernizimi i shqipes, pra, duhet parë edhe përmes pranimit të fjalëve të huaja, për të cilat, pa dyshim, ka nevojë shqipja standarde dhe për të cilat duhet të ketë një planifikim a një politikë gjuhësore.

### Dukuri të reja në gjuhën e të rinjve

Gjuha është kodi më i rëndësishëm i komunikimit në shoqërinë njerëzore, edhe kodet e tjera konvertohen vetëm nëpërmjet saj. Por, që të realizohet një komunikim normal, duhet patjetër që gjithë elementët e këtij kodi të njihen si nga dhënësi ashtu dhe marrësi i mesazhit.

Me të drejtë shtrohet pyetja se si mund të realizohet komunikimi i plotë e pa vështirësi mes të rinjve, ku ligjërimi i tyre është i mbushur plot shkurtesa, të cilat njihen nga dërguesi i mesazhit, por mund të mos kapen lehtë nga marrësi i tij. E për pasojë procesi komunikativ të zhvillohet plot ndërprerje. Dukuria e zhvillimit të gjuhës të të rinjtë është e njohur në të gjithë botën. Këto shqetësime janë në gjithë gjuhët, ku të rinjtë janë të prirur ta fshehin mesazhin, nga prindërit ose dikush tjetër ose për të realizuar një komunikim të shpejtë, përdorin me vend e pa vend shkurtesat. Dikur shkurtesat përdoren nga studentët gjatë mbajtjes së leksioneve për t'i shënuar gjithë fjalët e pedagogut. Ndërsa sot shkurtesat në gjuhën e të rinjve lidhen me përdorimin masiv të internetit. Ky duhet konsideruar si një zhvillim i ri në gjuhë. Gjuha me të cilën komunikojnë të rinjtë është larg normave të shqipes standarde, sepse realizimi i një komunikimi të rregullt kërkon që fjalët të shkruhen të plota. Por, është realitet që fjalori i të rinjve shpesh është i mbushur me fjalë të huaja, si: *ok*, *bay*, *ciao*, *etj*. Ja disa mënyra komunikimi të të rinjve që kemi mundur të vjelin:

Disa shkurtime që përdoren në SMS me celular:

**Fis** - flasim

**Flm** - faleminderit

**Skgj** - s'ka gjë

**Cpb** - çfarë po bën

**Ckb** - çfarë ke bërë

**Vëll** - vëllim

**Shek** - shekulli

**Bkr** - bukur

**Prsh** - përshëndetje

**Tak** - takohemi

**Tn** - tani

**Tltm** - të lutem

**Prz** - për zotin

tkshxh-të kam shumë xhan

Ne me të drejtë shqetësohemi për gjuhën, sepse ajo na siguron jetëgjatësinë, ajo është mjeti kryesor i komunikimit dhe përbën palcën e kombit. Gjithkush i vë re këto deformime si në formën e shkruar ashtu dhe në formën e folur. Përveçse ato deformojnë gjuhën, ofendojnë edhe bashkëfolësin, humbasin shumë nuanca gjuhësore. E shkruara me kod është tjetër aspekt, ndërsa e shkruara me shkurtime është tjetër gjë. Por duhet të kemi parasysh se në komunikim e sotëm kanë hyrë në masë mjete të reja komunikimi, kur çdo i ri ka në përdorim



telefonin Aifon dhe këtyre mjeteve të reja të komunikimit njerëzit duhet t'u përgjigjen. P. sh. komunikimi në Twitter kërkon sa më shumë mesazhe me shkurtësi. E keqja gjuhës, siç e shprehëm më lart, i vjen kur shkruajmë me karakter zyrtar, kur shkruajmë në shkolla, universitete, prandaj në këto institucione duhet të japim modelet e të shkruarit sa më herët që të rrënjoset mënyra e të shkruarit. Kur të rinjtë komunikojnë me njeri-tjetrin nuk ka shqetësime, por duhet të shqetësohemi kur kjo mënyrë të shkruarit të mos ngulitet të ata kur shkruajnë letra, kërkesa, detyra kursi, etj. Prandaj është detyrë kombëtare që nëpërmjet shkollës, mediave zyrtare të japim modele të qarta.

### Diskutimet rreth standardit

Në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit shpallet se "populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar, norma kombëtare e së cilës është kristalizuar në të gjitha hallkat kryesore të strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore. ". Kongresi, gjithashtu, porositi që "duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si dhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, Rregullave të drejtshkrimit t'u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet dhe plotësimet e duhura". (10).

Pra, Kongresi i Drejtshkrimit shprehet qartë se është i nevojshëm përmirësimi i standardit për probleme që nxjerr praktika ligjërimore, duke vlerësuar se kodifikimi i drejtshkrimit nuk mund të kishte sukses pa përvetësimin dhe zbatimin e normave të tij. Prandaj ai u bën thirrje gjithë institucioneve, shkollës shqiptare për ta vlerësuar përvetësimin e normave të njësuara të gjuhës letrare e të drejtshkrimit, institucioneve të teksteve shkollore të botonin tekste ndihmëse e mjete të tjera për zotërimin praktik të këtyre normave. Për këtë qëllim u botuan Rregullat e drejtshkrimit, të pikësimit, Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, etj.

Në këto vite të tranzicionit nuk kanë munguar edhe zërat ndryshe që kanë kontestuar gjuhën standarde shqipe e Kongresin e Drejtshkrimit. Natyrisht, nevoja për zhvillimin dhe përsosjen e saj të mëtejshme mbetet një kërkesë e vazhdueshme. Konfuzion po sjellin dhe pretendimet e një grupi gjuhëtarësh që kërkojnë përmirësimin e standardit dhe të variatetit letrar që duhet të qëndroj në bazë të tij. Por, zhvillim dhe përsosje nuk do të thotë që në gjuhë të mund të bëhen ndërhyrje arbitrare nga një tifozllëk krahinist, siç po pretendohet këto dy dhjetëvjeçarët e fundit. Ky grup gjuhëtarësh e konsideron standardin si sajim artificial dhe kolonizim gjuhësor krahinor. Për këtë ata nënshkruan dhe një Deklaratë ku shprehën mendimin se në të ardhmen duhet të thirret një Kongres i Tretë për të shqyrtuar problemet e gjuhës letrare kombëtare, të cilët dolën dhe me disa teza themelore, ku midis të tjerash përmendim: *gjuha letrare e njësuar duhet të rishikohet, krahas të shkruhet gegënishtja letrare dhe e ardhmja e letrarishtes do t'i lihet momentit të favorshëm*. Përfaqësuesit e antistandardit flasin për padrejtësinë që i është bërë gegërishtes, për dhunë ndaj gjuhës së mëparshme zyrtare, etj. Akademik Rexhep Qosja, duke iu drejtuar këtij grupi gjuhëtarësh, shkruan:

"...asnjë popull sot në Ballkan, asnjë popull në Evropë, sot nuk humb kohën historike me debate pseudoshkencore dhe pseudokulturore se cili dialekt është dashur të bëhet bazë e gjuhës standarde, nuk e humb kohën historike me përpjekjet krahinore për rrënimin e gjuhës standarde, që në thelb mund të sendërtohen vetëm me çënime të rënda të përbashkësisë kombëtare, me përçarje kombëtare"(11).

**Si përfundim**, mund të themi se shkalla e suksesit në përvetësimin e normave të shqipes standardenuk varet vetëm nga kodifikimi i këtyre normave, por edhe nga pranimi dhe zbatimi i tyre nga folësit, gjë që është themelore për suksesin e planifikimit gjuhësor. Është detyrë jona dhe e gjithë shoqërisë të krijojmë një front unik të përvetësimit dhe përdorimit të drejtë të shqipes standarde, ku në ballë të këtij fronti duhet të qëndrojë shkolla, media elektronike dhe ajo e shkruar, gjithë institucionet e shtetit shqiptar. Shteti nuk e ka treguar kujdesin e duhur ndaj gjuhës së shkruar, ndaj gjuhës letrare shqipe të njësuar kombëtare. Përdorimi i standardit ka qenë në një nivel të kënaqshëm në sistemin që lame pas, edhe pse nuk kishim mjetet e sotme, jo më kompjutera e telefona modernë, por as makina shkrimi, por botimet shkollore kishin gjuhë pa gabime; gjuha e gazetave dhe e botimeve zyrtare ka qenë e mirë, sepse edhe kujdesi ka qenë në shkallë të lartë. Tani jemi në pritje të realizimit të premtimit të Kryeministrit për vendosjen e figurës së korrektorit letrar në të gjithë praktikën shkrimore dhe botuese të shtetit, ashtu si e parakupton edhe VKM-ja e vitit 1974 për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar në të gjithë praktikën shkrimore dhe botuese të Republikës së Shqipërisë. Kujtojmë se kishte korrektor gjuhësor në organet e shtypit të kohës, si p. sh. në gazetën "Zëri i Popullit", i cili nuk lejonte gabime gjuhësore as të drejtuesit më të lartë të Partisë e të Shtetit.

Po edhe gjuhësia shqiptare ka pasur autoritetin e peshën e duhur në jetën e shoqërisë, njerëzit shqetësoheshin dhe ruheshin nga gabimet në të shkruar. Instituti i Gjuhësisë kishte edhe shërbimin e "Këshillimeve gjuhësore" dhe çdo ditë në telefonin 2509 përgjigjej një nëpunës roje, specialist i gjuhësisë, për të gjitha pyetjet që bëheshin nga njerëz të ndryshëm.

Vetëm një varietet standard me një normë të njëjtë drejtshkrimore të përbashkët për të gjithë bashkëkombësit shqiptarë dhe me një strukturë gramatikore e leksikore të përcaktuar nga norma të gjalla e të studiuar mirë, mund të përballojë nevojat kaq shumë të shtuara të shprehjes e të krijimit që u dalin sot shqiptarëve. Vetëm një gjuhë e tillë, e fuqishme dhe e përpunuar, po edhe e mbrojtur përkushtimisht nga rreziqet, gjithashtu aq të shumta, po edhe të shtuara dukshëm në ditët tona, mund të shpërfillë edhe ndarjen në shtete.

Të kujdesemi të gjithë për gjuhën duke e ngritur lart autoritetin dhe vlerësimin ndaj saj si **tipar themelor i përbashkësisë së kombit tonë shqiptar, pasi** nuk ka shteruar dhe nuk shteron krejt dashuria dhe kujdesi për shqipen, si palca e kombit tonë. Kombin e kemi ende të ndarë në disa shtete, gjuha shqipe e njësuar na bashkon dhe na lidh shpirtërisht e kulturorisht të gjithëve sa jemi: shqiptar të Republikës së Shqipërisë, të Kosovës, të trojeve shqiptare në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në



diasporat e hershme e të reja të shqiptarëve në Botë. Prandaj e quaj me vend të përmend thirrjen që bënte prof. Shaban Demiraj, me rastin e 25-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, ku u vendos përfundimisht përdorimi i një gjuhe letrare të përbashkët

për të gjithë shqiptarët: "Të përpiqemi të gjithë për të shpëtuar nga rreziqet që po i kërcënohen gjuhës sonë të bukur, e cila është jo vetëm thesari më i çmuar që kemi trashëguar nga të parët tanë, por edhe shenja dalluese kryesore e kombit shqiptar".

### Referime bibliografike

1. Kryeziu, B. , *Standardi i shqipes dhe disa probleme rreth tij*, në "Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë", Ohër, 2007, f. 93
2. Çabej, E. , *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në Studime gjuhësore, VI, Prishtinë, 1977, f. 329
- 3-4. Rrokaj, Sh. , *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë, 2005, f. 137
5. Shkurtaç, Gj. , *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003, f. 59
6. Qosja, R. , *Nocione të reja albanologjike*, Prishtinë, 1983, f. 146
7. Thomai, J. , *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 303.
- 8, 10. Memushaj, R. , *Gjuha shqipe në shtratin e prokrustit*, Tiranë, 2013, f. 23, 25
9. Kostallari, A. , *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Tiranë, 1980, f. 9
11. Qosja, R. , *Nëntë urime Shqiptares në "Shqipëria dhe Kosova"*, TOENA, Tiranë, 2013, f. 413